



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DROPULL

KËSHILLI BASHKIAK

PROJEKT VENDIM

NR., DATË. 03.2026

PËR

“MIRATIMIN E PËRFITUESVE DHE MASËS MUJORE TË PËRFITIMIT NGA FONDI SHITESË MBI FONDIN E KUSHTËZUAR TË NDIHMËS EKONOMIKE, PËR MUAJI MARS 2026”.

Në mbështetje të nenit 24, “Funksionet e bashkive në fushën e shërbimeve sociale”, Ligji 139/2015, “Mbivetqeverisjen vendore”, nenit 21, të Ligjit 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, indryshuar, VKMnr.597, datë 04.09.2019, “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, indryshuar, Vendimit të Këshillit të Bashkisë nr.68 date 17.12.2025, “Përmiratimin e kriterëve për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar të ndihmës ekonomike, për familjet dhe individët nënevojë, për vitin 2026”, Vendimit të Këshillit të Bashkisë nr.68, dt.17.12.2025 me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

1. Miratimin e listës së përfituesve dhe masës mujore të përfitimit nga fondi shtesë mbi fondin e kushtëzuar të ndihmës ekonomike, për familjet dhe individët nënevojë, për muajin Mars 2026, sipas tabelave bashkangjitur.
2. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe e Strehimit për zbatimin e këtij vendimi..
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55 ,pika 6 te ligjit nr.139/2015” Për Vetëqeverisjen Vendore”).

KRYETAR
Donika BAUÇI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DROPULL
KËSHILLI BASHKIAK**

PROJEKTVENDIM

NR. DATE 31/03/2026

PËR

**“MIRATIMIN E TAVANEVE PËRGATITORE TË PROGRAMIT BUXHETOR
AFATMESËM 2027-2029”.**

Në mbështetje të nenit 34, pikat 5, te ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetqeverisjes vendore”, të, Udhëzimit të MFE nr.23, dt.30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të njëjësive të vetqeverisjes vendore”, i ndryshuar, Udhëzimit të MF nr.07, datë 27.02.2026, “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm vendor 2027-2029”, Vendimit të Keshillit të Bashkisë nr.67, datë 17.12.2025, “Për miratimin e kalendarit të PBA 2027-2029”, Vendimit të Këshillit të Bashkisë nr.08 , datë 27.02.2026, “Për miratimin e raportit për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave, në kuadër të përgatitjes së PBA2027-2029”, Vendimit nr.02, datë 19.01.2026, të Kryetarit të Bashkisë “Për ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik dhe Ekipeve të Menaxhimit të Programeve, në kuadër të PBA 2027-2029”, në mbledhjen e datës 31.03.2026, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK

VENDOSI:

1. Miratimin e Tavaneve Përgatitore të Programit Buxhetor Afatmesëm 2027-2029”, (sipas tabelave bashkangjitur).
2. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë për zbatimin e këtij Vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr.139/2015”Për Vetëqeverisjen Vendore”).

**KRYETAR
Donika BAUÇI**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DROPULL
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. ___ Prot

Jergucat më .03.2026

Projekt Vendim

Nr. ___ Datë .03.2026

Për një ndryshim në Vendimin Nr. 58, datë 30.10.2025 «Për Miratimin e Nivelit të Pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar dhe të nëpunësve civil të Bashkisë Dropull, për vitin 2026»

Këshilli Bashkiak Dropull në mbledhjen e tij të datës / /2026, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” Kreu IX, të nenit 18 dhe nenit 26 pika 4, të Ligjit 7961 datë 12/07/1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, dhe të akteve të tjera nenligjore të dala në zbatim të tyre, të Ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar,

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 127, datë 27/02/2026 « Për disa ndryshime në vendimin të Këshillit të Ministrave nr.425 datë 26/06/2024 “Për Miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve mesimorë dhe të punonjësve të tjerë jomesimorë në institucionet arsimore dhe në institucionet plotësuese të sistemit arsimor parauniversitar” Lidhja Nr.3»,

VENDOSI:

1. Miratimin e nivelit të pagave , pagë për pozicion dhe grupi i diplomës për punonjësit mësimorë në institucionet arsimore të sistemit arsimor parauniversitar

| ARSIMI PARAUNIVERSITAR-PARASHKOLLOR | | | | | | |
|--|---------------------------------------|--------------------------------|----------------------------------|---|---|----------------------------|
| Nr. | Emertimi i pozicionit të punës | kategoria | Paga e grupit të diplomes | Shtesa për kategorinë e kualifikimit | Shtesa për vjetërsi | Shtesa për pozicion |
| 1 | Edukator në kopesht femijesh | VKM 127 Datë 27/02/2026, | 1 ose 2 ose 3 ose 4 | 10% e PG për kategorinë «mësues i kualifikuar», 20% e PG për kategorinë | 0.6% x 58000 (1- 10 vjet) 0.8% x | 61.000 |

| | | | | | | |
|--|--|-------------------------|--|--|--|--|
| | | Lidhja Nr. 3, pika 8 | | «mësues specialist», 30% e PG për kategorinë «mësues mjeshtër» | 58000 (11-20 vjet) 1% x 58000 (21-30 vjet) | |
|--|--|-------------------------|--|--|--|--|

| VLERA E PAGËS SË GRUPIT PËR GRUPET E DIPLOMAVE TË ARSIMIT PARASHKOLLOR | | |
|---|---|---|
| Grupi i diplomës | Niveli i Kualifikimit sipas Kornizes Sh qiptare te Kualifikimeve (KSHK) | Vlera e shteses se nivelit te kualifikimit (Leke/muaj) |
| 1 | Niveli 7 i KSHK (Master i Shkencave, Master i Arteve. Master profesional te perfituar ne fund te studimeve te ciklit te dyte, me 120 kredite dhe me kohezgjatje normale 2 vite akademike. Te barazvlefshme me to sipas Legjislacionit te Arsimit te Larte) | 14000 lekë |
| 2 | Niveli 7 i KSHK (Master Profesional. Te barazvlefshme me to sipas Legjislacionit te Arsimit te Larte) | 12000 lekë |
| 3 | Niveli 6 i KSHK (Bachelor. Te barazvlefshme me to sipas Legjislacionit te Arsimit te Larte) | 10000 lekë |
| 4 | “Diplome e matures shtetere” , te shkolles se mesme pedagogjike, per te cilat jepet tituli “Mesues I shkolles fillore. “Diplome e matures shtetere” , te shkolles se mesme profesionale, per te cilat fitohet specialiteti per mesuesi. “Diplome e matures shtetere” , te shkollave me drejtim te orientuar. Diplome mbi shkollen e mesme. Te tilla konsiderohen te gjitha diplomat e kurseve me program mesimor te miratuar nga muinistria pergjegjese per arsimin, si dhe diplomat joniversitare profesionale dyvjecare. Diplome e shkolles se mesme profesionale | 8000 Leke |

2. Per zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkise.
3. Ky vendim hyn në fuqi dhjetë ditë pas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr. 139/2015, “ Për vetëqeverisjen vendore”).

KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK

Donika BAUÇI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DROPULL

RELACION

Për një ndryshim në Vendimin Nr. 58, datë 30.10.2025 «Për Miratimin e Nivelit të Pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar dhe të nëpunësve civil të Bashkisë Dropull, për vitin 2026»

Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak,

Pas hyrjes në fuqi të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 127, datë 27/02/2026 « Për disa ndryshime në vendimin të Këshillit të Ministrave nr.425 date 26/06/2024 “Për Miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve mesimorë dhe të punonjësve të tjerë jomesimorë në institucionet arsimore dhe në institucionet plotësuese të sistemit arsimor parauniversitar” Lidhja Nr.3»,

1. Këkojmë Miratimin e Nivelit të Pagave, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave të sipercituar, për punonjësit mësimorë në institucionet arsimore të sistemit arsimor parauniversitar.

Konceptoi: Amalia Millo

KRYETARI
Dhimitraq TOLI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DROPULL

DREJTORIA E BURIMEVE NJEREZORE DHE E SHERBIMEVE MBESHTETESE



Nr. Prot

Jergucat më ___/___/ 2026

Projekt Vendim

Nr. ___ Date ____ . ____ . ____

Për Miratimin e Rregullores së Brëndshme për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kopetencat e administratës së Bashkisë Dropull, për vitin 2026

Këshilli Bashkiak Dropull në mbledhjen e tij të dates / /2026, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të Kushtetutes e Republikës së Shqipërisë 1998, të Ligjit nr. 139, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” i ndryshuar, të Ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë (i ndryshuar), të Ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e Etikës në Administratën Publike”, të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike"; të ligjit nr.9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit

VENDOSI:

Miratimin e Rregullores së Brëndshme për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kopetencat e administratës së Bashkisë Dropull, për vitin 2026

Kryetare

Donika Bauçi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DROPULL



Nr. Prot

Jergucat më / / 2026

RELACION

Për Miratimin e Rregullore së Brëndshme për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kopetencat e administratës së Bashkisë Dropull, për vitin 2026

Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak,

Përpilimi dhe miratimi i kësaj Rregulloreje të organizimit dhe funksionimit të administratës bashkiake bazohet në Ligjin 139/2015 “Per vetqeverisjen vendore” neni 64 pika j “Kryetari i bashkise miraton strukturën, organiken e kategorite e pagave per cdo pozicion te sherbimit civil dhe rregulloret baze te administrates se bashkise dhe të njësive e institucioneve buxhetore në varësi të bashkisë ne perputhje me legjislacionin ne fuqi”.

Kjo rregullore ka për objekt krijimin e një kuadri rregullator për funksionimin me efikasitet dhe efijçencë të veprimtarisë së administratës së Bashkisë Dropull, për realizimin e funksioneve dhe kompetencave të saj të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Të disiplinojë aktivitetin e bashkisë për realizimin e detyrave funksionale dhe kompetencave të saj. Të krijojë kushte për veprimtari transparente të administratës së bashkisë ndaj publikut dhe organeve shtetërore;

Të përcaktojë rregullat e bashkëpunimit ndërmjet strukturave të ndryshme të bashkisë. Të krijojë një instrument për ndarjen e detyrave, në varësi të strukturës së bashkisë.

Te krijoje kornizen e nevojshme rregulluese per te realizuar nje funksionim sa me te kontrolluar efektiv dhe eficient te administrates se bashkise.

Te krijoje nje kornize e cila i krijon administrates bashkiake detyrimin qe ne punen e saj te respektoje parimet e llogaridhenies, transparences hapjes dhe gjithheperfshirjes.

Te mundesoje profesionalizem dhe qendrueshmeri ne funksionimin e brendshem te bashkise.

- Ne Rregulloren e Brendshme te vitit 2026 te Bashkise Dropull jane bere ndryshimet ne lidhje me rregulloren e vitit 2025 si me poshte:

- Janë shtuar detyrat e vendit të punës të Përgjegjësit të Sektorit të Mbetjeve Urbane dhe Pastrimit, në Drejtorinë e Shërbimeve Publike (Rregullore e Brëndshme për vitin 2026, neni 107).

- Janë shtuar detyrat e vendit të punës të Përgjegjësit të Sektorit të Mirëmbajtjes së Rrugëve Rurale dhe Objekteve Publike, në Drejtorinë e Shërbimeve Publike (Rregullore e Brëndshme për vitin 2026, neni 108).

- Janë shtuar detyrat e vendit të punës të Përgjegjësit të Sektorit të Mirëmbajtjes së Godinave të Bashkisë dhe Varrezave të fshatrave, në Drejtorinë e Shërbimeve Publike (Rregullore e Brëndshme për vitin 2026, neni 109).

-Jane shtuar detyrat e vëndit të punës të Përgjegjësit, në Drejtorinë e të Ardhurave (Rregullore e Brëndshme për vitin 2026, neni 80).

-Jane mbyllur pozicionet e punës e Administratoreve të Njërive Administrative.

Duke ju falenderuar,

Konceptoi: Amalia Millo

K R Y E T A R I

Dhimitraq TOLI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DROPULL
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. Prot

Date .03.2026

PROJEKT-VENDIM

Nr. , datë: 31.03.2026

**“PER MIRATIMIN E RAPORTIT TE PERFORMANCES SE KESHILLIT BASHKIAK
DROPULL PER VITIN 2025”**

Në mbështetje të ligjit 139/2015”Per Veteqeverisjen Vendore”,i ndryshuar ,si dhe Rregullores se Keshillit Bashkiak Dropull ,pas shqyrtimit te raportit te paraqitur nga sekretari i Keshillit Bashkiak per vitin 2025,,Keshilli Bashkiak :

V E N D O S I :

1. Miratimin e raportit te performances se Keshillit Bashkiak Dropull per vitin 2025”.
Sipas raportit bashkangjitur vendimit.
2. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”).

KRYETAR

Donika Bauçi

RELACION

RAPORTI I PERFORMANCËS SË KËSHILLIT BASHKIAK DROPULL PËR VITIN 2025

Këshilli Bashkiak Dropull , si Organi Përfaqësues dhe Vendimmarrës i Qeverisë Bashkiake, ka ushtruar

përgjegjësitë e tij qeverisëse, duke respektuar parimet e demokracisë vendore, transparencës qeverisëse, ligjshmërisë.

Këshilli i Bashkisë Dropull ushtron funksionin e tij në përputhje me ligjin 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, dhe Rregulloren e funksionimit të Këshillit të Bashkisë Dropull miratuar me vendim të këshillit të bashkisë nr. 14, datë 28.02.2020.

Veprimtaria e tij është zhvilluar mbi bazën e parimeve të demokracisë vendore ,transparencës ,përgjegjshmërisë dhe mbrojtjes së interesit publik,duke përdorur me efektivitet burimet njerëzore,financiare,fizike dhe natyrore.

Raporti I performancës për vitin 2025 pasqyron punën dhe aktivitetet e Këshillit Bashkiak Dropull në zbatim të vendimit nr.7 dt 29.01.2025,”Për miratimin e planit të aktiviteteve dhe buxhetit të Këshillit të Bashkisë për vitin 2025”.

Gjatë këtij viti këshilli ka ushtruar në mënyrë aktive rolin e tij vendimarrës,perfaqësues dhe mbikqyres/monitories,duke garantuar transparencë,llogaridhënie dhe pjesëmarrje të qytetarëve në proceset e Qeverisjes vendore.

VENDIM MARRJA:

Për periudhën Janar-Dhjetor 2025 Këshilli i Bashkisë Dropull ka zhvilluar 14 mbledhje nga të cilat 12 të radhës dhe 2 jashtë radhës me kërkesë të kryetarit të Bashkisë.

Jane miratuar gjithsej 68 vendime prej të cilave 33 vendime normative të cilat janë konstatuar të bazuar në ligj dhe kanë marrë konfirmimin e institucionit të Prefektit, ndërsa nuk ka vendime të pakonfirmuar.

Gjithashtu, për periudhën Janar-Dhjetor 2025 ka pasur 35 vendime me karakter individual. Mbledhjet janë trasmetuar live që komuniteti të ndjek direkt mbledhjet dhe të japë mendime dhe sugjerime e tij për vendimet dhe çështjet që janë shqyrtuar.

Kryesia e Këshillit ka funksionuar rregullisht për çdo mbledhje duke diskutuar për pikat e rendit të ditës propozuar nga ekzekutivi.

Mbledhjet e komisioneve janë realizuar 16 mbledhje komisioni.

Mbetet sfidë agazhimi me I madh I këshilltarëve në mbledhjet e komisioneve, si dhe dokumentimi I veprimtarisë,si dhe mendimi I anëtarëve të komisioneve.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DROPULL
KËSHILLI BASHKIAK



Nr. Prot

Jergucat më / / 2026

Projekt Vendim

Nr. ___ Date ___:___:___

Për

Ngritjen e Komisionit Këshillimor për dhënien e titujve vendorë të nderit, për vitin 2026

Këshilli Bashkiak Dropull në mbledhjen e tij të datës ___/___/2026, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në ligjin 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, në Rregulloren e Këshillit Bashkiak Dropull, në ligjin nr. 94/2022 “për titujt e nderit dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, në Seksioni 3, neni 14, neni 15, të VKM-së nr.861 datë 10/12/2014 “Për rregullat e hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimore për dhënien e titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

Ngritjen e Komisionit Këshillimor, i përbërë nga anëtarët e mëposhtëm:

1. Z. Panajot Dhefto- Kryetar
2. Z. Ervin Llahana- Sekretar
3. Znj. Aleksandra Loli- Anëtare
4. Znj. Evridhiqi Drapo- Anëtare
5. Z. Gligor Bezati-Anëtar

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë

Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit)

**Kryetare
Donika Bauçi**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DROPULL



RELACION

Për

Ngritjen e Komisionit Këshillimor për dhënien e titujve të nderit për vitin 2026

Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak,

Referuar dispozitave të ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, në Rregulloren e Këshillit Bashkiak Dropull, në ligjin nr. 94/2022 “për titujt e nderit dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, në Seksioni 3, neni 14, neni 15, të VKM-së nr.861 datë 10/12/2014 “Për rregullat e hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimore për dhënien e titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”,

Duke qenë se Këshilli Bashkiak është autoritet përgjegjës për dhënien e titujve vendorë të nderit për shpërblimin e veprimtarisë së shquar të çdo personaliteti shqiptar ose të huaj në dobi të Bashkisë Dropull ose për veprimtari për mbrojtjen dhe promovimin e interesave të saj, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë të ngrihet Komisionit Këshillimor, i përbërë nga anëtarët e mëposhtëm:

1. Z. Panajot Dhefto- Kryetar
2. Z. Ervin Llahana- Sekretar
3. Znj. Aleksandra Loli- Anëtare
4. Znj. Evridhiqi Drapo- Anëtare
5. Z. Gligor Bezati-Anëtar

Duke ju falënderuar,

K R Y E T A R I
Dhimitraq TOLI



BASHKIA DROPULL
KRYETARI



Nr. Prot

Jergucat më // 2026

Lënda: Dërgohet material për shqyrtim e miratim.

Znj. Donika BAUÇI

KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK DROPULL

E nderuar zonja Kryetare,

Bashkëngjitur po ju dërgojmë projektvendimin, dhe relacionin shoqërues, për:

Ngritjen e Komisionit Këshillimor për dhënien e titujve të nderit, për vitin 2026.

Me respekt,

K R Y E T A R I
Dhimitraq TOLI

Miratoi:

Panajot Dhefto: Nënkryetari Ekonomik

Konceptoi:

Evridhiqi Drapo- Specialiste e Kulturës, Arsimit dhe Sportit

Datë: / /2026

Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: 1 (një)

Nr. i faqeve A4 të relacionit shoqërues: 1 (një)

Nr. i fletëve të dokumenteve që shoqërojnë projekt vendimin: 2 (dy)